

VALLJA II: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

*Pastaj Këndonjësi ligjëron Psalmin Nistor, dhe vazhdon regulla e zakontë e Mbrëmësore.*

### THIRRTORET, T. I.

Thomaj kërkoj që ta prekte shenjën e gozhdave, dhe ti o Krisht e ftove, dhe durove nxonitjen, ashtu siç e durove Kryqin për ne, dhe varrimin e trupit tënt, pastaj u-ngjalle i tridiçim si Përendi, dhe u-çfaqë nër dishepujtë.

Thomaj provoj me dyshimin çudit' e Zotit Krisht, se si në Ferrin zbriti, dhe u-ngjall i tridiçim, se duarte ia pa i preku me gisht, mun në shënjat e gozhdave, e pa dhe brinjën e çpuar pashpirtërisht, nga e cila rrodhi uj' e gjak.

Kur ishin mbledhur të gjithë, pas kryqësimit tënt, Shën Apostujt' e trëmbur, derëmbyllur nga frika, pa pritur mun' në mes u-çfaqë o Krisht, edhe paqen të gjithëve, me Shpirtin Shenjt u dhurove dhe Shën Thomajt, ia tregove shenjat faqeza.

LAVDI DHE TANI, T. II. Pas Ngjalljes sate o Krisht, kur ishin mbledhur dishepujtë, edhe dyertë ishin të mbyllura, hyre brënda befas, dhe u qëndrove në mest, dhe u fale paqen të gjithëve, edhe Shën Thomaj u-bint, nga brinja dhe duartë e çpuara, dhe të lëçiti Perëndi dhe Zot, edhe Shpëtimtar të besnikëve.

### PASVARGJET, T. II.

#### PAS IKOS TU EFRATHA

Pa dhe besoj Thomaj, që Krishti Shpëtimtari, për

## E DIELA E SHEN THOMAJT

*Që të Dielën e Shën Thomajt gjer në ditën e Shestjes, pasi bekon Pifti dhe nis Mbrëmësoren, këndohet tri herë Përlëshorja e Pashkës, si pason:*

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: Lavdi Trinisë së bashkëqënshime, jetë-bërëse dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

VALLJA I: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

ne në varrin hyri, dhe jashtë prapë dolli, i gjallë Perëndi dhe Zot.

Çdo Apostull të pa, kur dyert' ishin mbyllur, edhe u fale paqen, dhe u dhurove Shpirtin, për ndjesën e mëkatave.

O Perëndi dhe Mbret, me sy o Krisht të pashë, me zëmër të kam dashur, dhe ty të kam besuar, o ngjallës i të vdekurve.

LAVDI DHE TANI. Paqen o Shpëtimtar, dhe ndjesën na dhurove, për fajet dhe mëkatat, me lutjet e paprera, të Zonjës dhe Hyjlindëses.

#### PERLESHORJA, T. R.

Kur ishe i shiluar në varrin tënt, ti o jet' u-ngjalle së vdekurësh, o Krisht Perëndi; edhe kur dyert' ishin mbyllur, dolle përpar' Apostujv' e Dishepujve, dhe përsërite nër ne Shpirtin Shenjt me ata, dhe përdëllimin e math o Zot.

#### NDENJESORET, T. I.

##### PAS TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Nga frika e Judenjve kur u-fshehn' Apostujtë, edhe në Sion u-përmblohnë dhe dyert' i mbyllnë; u-dolle pa prituri mun' në mest, dhe paqen ua fale me gëzim, u përndave frymësimin e Shpirtit Shenjt, të lidhin edhe të zgjidhin, fajet edhe mëkatat përmi dhe, binde dyshonjësin Shën Thoma, kur të preku dhe të pa me sy, Zot i mëshirave.

##### PAS TON TAFON SU SOTIR

U dolle mun' në mes, kur u-mblohnë të trëmbur,

dishepujt' o Jesu, dhe atje u tregove, çdo shenjë të peronave, përmi brinjën dhe duartë, mirë po Thomaj, s' u-ndoth atje me të tjerët, u thërriste pra. Në mos e pafsha me sytë, askurrë nuk e besonj.

#### LAVDI DHE TANI. Gjithajo.

##### PAS TON TAFON SU SOTIR

Thoma tani m'i pe, brinjën duart' e këmbët, tani pra e beson, që u-ngrita nga varri, u thoshte me zë të math, si u-ngjall prej së vdekurësh, Zoti Jesu Krisht, gjith' Apostujve të mbledhur; edhe Shën Thomaj, u-bint dhe thirri me besë: Ti je im Zot dhe Perëndi.

#### LAVDI DHE TANI. Gjithajo.

##### SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Që prej djalërisë, shumë pasione më lëftojnë. . . .

##### PAREVARGU

Lavdëroje Zotin o Jerusalem, adhuroje Perëndinë o Sion.

##### SHKURTORJA, T. T. IV

Thomaj me dorën trazovaçe, ta nxoniti brinjën jetëdhënëse, o Krisht o Perëndi, kur ishin dyertë të mbyllura, dhe me Apostujtë e tjerë thirri: Ti je Zoti im dhe Perëndia im.

##### SHTEPIA

Qysh nukë shkriu dora e dishepullit, kur e preku brinjën e zjarrtë të Zotit? Po ky hir iu-dha Thomajt, i cili i thirri Krishtit: Ti je Zoti im dhe Perëndia im.

## SINAKSARI

Gjthë sot, të Dielën e Dytë pas Pashkës, kremtojmë Tetoren e Ngjalljes dhe Prekjen e Apostullit Shën Thoma.

Me nërmjetimet e Apostullit Shën Thoma, o Krisht o Perëndi, mëshirona. Amin.

## ZBRITESORET E PASHKES, T. I.

I. Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazëllohuni pra, Pashka e Zotit Pashka. Se prej vdekjes në gëzim, dhe prej dheut lart në qjell, na shpuri me këngë mundëse Zoti Krisht, Shpëtimtari i shpirteve.

III. Eni pini ujë krejt të re, që s' e nxori prej shkëmbit, shkopi çuditërisht, po që buron si rrëke, nga varri i Zotit Jesu Krisht, që jetën na shiguron.

IV. Nga fron' i qjellit o Profet, Perëndifolës Abakum, eja sot me ne dhe tregona, dritën edhe Engjëllin, i cili sheshit lajmëron: Sot i ka ardhur botes shpëtimi, se Jesu Krishti u-ngjall, si Zot dhe Perëndi.

V. Mëngoni menatë dhe eni, dhe le ti shpiem këndime, si myrrë Zotit në varrin, dhe do ta shikojmë Krishtin diellin që u dhuron, jetën dhe paqen të gjithëve.

VI. Kur zbritë gjer në funt të dheut në Ferr, dhe dërmovë gjithë llozet e burgut, çlirove skllevet e jetëve, edhe pas tri ditsh, prej balenës si Jonaj, dolle jashtë nga varri.

VII. Tre Djemat midis flagës i mproj me shi, dhe vetë u-bë njeri, dhe pësoj si ne, dhe me Pësimin shpëtimtar, na stolisi me jetën që nukë vdes, i vetëmi Perëndi i bekuar, i Atërve lavdi më ty.

VIII. Dita m' e shkëlqyer është Pashk' e Madhe, e para dit' e javës, që mbretëron mi të gjitha, panair dhe kremtim, i kremtimeve dhe i panaireve. Pra sot e bekojmë, për jetë Jesu Krishtin.

## UNGJILLI I MENGJEZIT PAS MATTHEUT

Më atë kohë, të njëmbëdhjetë dishepujtë vajtin në Galile, në malin ku i kishte porrositur Jesuj. Dhe kur e panë, iu-falnë, po ca dyshuan. Dhe u-afrua Jesuj, dhe u foli dyke thënë: "Më është dhënë e tërë fuqia mi qjellin edhe mi dhenë. Ecëni, pra, dhe nxënësojini gjithë kombet, dyke i pagëzuar më emrin e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, edhe dyke i mësuar t'i ruajnë të gjitha ato, që ju porrosita. Dhe ja, unë do të jem bashkë me ju gjithë ditët gjer në mbarimin e jetës." Amin.

*Pastaj këndohen Madhështimet e Pashkës me Këngën IX të Kanunit.*

DERGIMESORET, T. III.  
PAS EPESKEPSATO IMAS

Eja prek-m'i duartë, dhe shenjat e peronave, edhe beso-më o Thoma, që vojta për të gjithë ju; pra që të gjithë lidhuni, dhe Perëndin' e gjallë, në botë lëçiteni. (2 herë)

Sot prënvera na gëzon, edhe krijes' e re këcen, sot Krishti çeli dyertë, dhe hyri dhe qëndroj në mest. Thomaj e preku dhe besoj, dhe thirri Ti je Zoti, ti je Perëndia im.

LAVDERIMET, T. I.  
PAS PANEFIMI MARTIRES

Kur dolle prej varrit me lavdi, o Jesu o Perëndi,

vulat i le të pazgjidhura, pa nonjë cen mi gur, gjithashtu pra hyre, nga dyert' e mbyllura, qëndrove mun në mes të dishepujve, paqe dhë gas u dhe, dhe për ndjesën e mekatave, i dërgove, me anën e Shpirtit Senjt. (2 herë)

Thomaj që e quanin Binjak, nukë ndodhej tok me ta, kur u-fanese o Zoti Krisht, pra s' e besonte dot, Ngjalljen e shkëlqyer, dhe u thoshte shokëve, në mos ia preksha vetë me gishtin tim, plagët e duarve, edhe shenjnat e peronave, nukë bindem, që u-ngjall së vdekurësh.

Siç deshe ashtu të tha Jesuj, eja prek-më o Thoma, dhe ver-e dorën dhe gishtin tënt, edhe mos kij dyshim, që kam trup njeriu, dhe besoje shigurisht, dhe botës ia lëçit me dishepujtë, edhe Thomaj i tha: Zoti im dhe Perëndia im, je përherë, nder edhe lavdi më ty.

#### LAVDI DHE TANI, T. T. II.

Tetë ditë pas Ngjalljes sate, o Mbret o Jesu Krisht, o Bir i vetëm i Atit, u-çfaqë nër dishepujtë, kur ishin dyertë të mbyllura, dhe u fale paqen të gjithëve; dhe dishepullit që dyshonte, ia tregove shenjnat e peronave; edhe ay u-bint edhe thirri: O Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

*Doksollogji e Madhe, Përlëshorja e Shën Thomajt, pastaj Mesha e Shën Joan Gojartit, e cila nis kështu:*

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: E bekuar është Mbretëria e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përhërë dhe në jetët e jetëve.

KORI. Amin.

*Pastaj këndohet Përlëshorja e Pashkës një herë prej Priftit edhe nga një herë prej të dy Valleve:*

### PERLESHORJA E PASHKES KHRISTOS ANESTI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë)

*Pastaj Dhjaku thotë Litaninë e Madhe. Në Hyrjen këndohet:*

#### PERLESHORJA E SHEN THOMAJT, T. R. ESFRAJISMENU TU MNIMATOS

Kur ishe i shiluar në varrin tënt, ti o jet' u-ngjalle së vdekurësh, o Krisht Perëndi; edhe kur dyert' ishin mbyllur, dolle përpar' Apostujv' e Dishepujve, dhe përsërite nër ne Shpirtin Shenjt me ata, dhe përdëllimin e math o Zot.

#### HYRTORJA E PASHKES

Nër Kishët e bekoni Perëndinë, Zotin nga burim' i Israelit. Shpëtona o i Bir i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojmë Alilluia.

*Përsëritet Përlëshorja e Shën Thomajt, pastaj këndohet:*

#### SHKURTORJA E PASHKES, T. T. IV.

O i pavdekur që zbrite në varr për ne, dhe e dërmove Skëterrën o Zot përdhe, dhe u-ngjalle si fitimtar o Krisht Perëndi, edhe Grave me myrra u thirre Gëzohuni, dhe u dhurove paqen e qjellit dishepujve, ti që u fale Ngjalljen të rënëve.

*Pas Litanisë së Vogël, Hymni Trishenjt, pastaj:*

## APOSTULLI

Zoti është' i math, edhe ka forcë të madhe.

Lavdërojeni Zotin, se është i mirë.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, Apostujtë bënë shumë shenja dhe çudira në mes të popullit. Edhe ishin që të gjithë të bashkuar në portikën e Sollomonit. Edhe asnjë nga të jashtëmët nukë kuxonte të lidhej me ta, po populli i madhështonte. Edhe ca më tepër shtohëshin me shumicë burra dhe gra, që e besonin Zotin, kështu që i nxirnin të sëmuret jashtë në sheshet, edhe i vinin mi shtrate dhe sofate që të pakën disave prej atyre tu binte përsipër hija e Pjetrit, kur të shkonte s' andejmi. Gjithashtu kishte ardhur një shumicë nga qytetet rreth e rrotull Jerusalemit, të cilët sillnin të sëmuret edhe të demonisurit, të cilët shëroheshin që të gjithë. Ahere u-ngrit Kryepriifti me shokët, të cilët ishin nga herezia e Sadukenjve, edhe u-mbushnë me zëmërim, edhe i vunë duartë mi Apostujtë, dhe i mbyllnë në burgun botor. Po Engjëlli i Zotit i hapi dyertë e burgut natën, dhe i nxori jashtë, dhe u tha: "Shkoni, dhe qëndroni në tempull, dhe folini popullit të gjitha fjalët e kësaj jete."

## UNGJILLI PAS JOANIT

*Këndohet Ungjilli Mëngjedor IX (shiko Kremtoren, f. 148-150)*

*Në "Veçan Tërëshenjtën," këndohet:*

## MADHESTIMI, T. I.

Ty llambadhen e shkëlqyer, që na linde Zotin

Krisht, ty lavdinë qjellore, dhe më të lartën nga të gjitha krijesat, të madhështojmë plot me mall.

## KUNGATORJA

Lavdëroje Zotin, o Jerusalem, dhe adhuroje Perëndinë, o Sion. Alilluia, alilluia, alilluia.

*Në vënt të "Pamë Dritën," këndohet:*

## PERLESHORJA E PASHKES

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

*Pas Uratës Përpara Tribunës, "Emri i Zotit," pastaj:*

## PERLESHIMI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh, me nërmjetimet e Shën Marisë dhe të gjithë Shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.